



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 4136 Më Dt. 13.10.2020
Br. prot. 4136 Më Dt. 13.10.2020

Në mbështetje të nenit 5 lidhur me nenin 12 dhe 22 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha Ordinancave veterinarë të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda territorit të Komunës së Rahovecit dhe që kanë përvojë në kontrollën dhe vaksinimin e bagëtive të trasha, bagëtive të imëta dhe qeneve shtëpiak me pronar në Komunën e Rahovecit, të cilat janë:

Qëllimi

Qëllimi dhe objektivat e përgjithshme të kësaj thirrjeje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për ambulancat veterinarë që kanë përvojë dhe që ushtrojnë këtë fushë të veprimit.

- a) Sëmundjet e kafshëve të shkaktuara nga klostidet janë infeksion toksik në një periudhë akute të cilat në fund të qojnë në vdekjen e kafshës. Tetanoza, butilizmi, edema malinje, enterotoksemia anaerobe konsiderohen të jenë sëmundje kryesore që i përkasin grupit klostidial të kafshëve janë sëmundje shumë të rrezikshme që kalojnë nga kafshët tek njeriu me humbje shumë të madhe ekonomike tek kafshët. Shkaqet e klostridiozës në trup janë gjithmonë patogjenët e saj, clostridium botulinum (shkakton butilizmin), clostridium tetani (agjent shkaktar i tetanozit), clostridium perfringens dhe clostridium septicum të cilat qojnë në edem malinje dhe enterotoksima anaerobe në kafshë, konsiderohen më të zakonshme në mesin e kafshëve.
- b) Sëmundjet klostridiale janë sëmundje shumë të rrezikshme që kalojnë nga kafsha te njeriu, me humbje shumë të mëdha ekonomike. Janë gram pozitive, rezistente ndaj nxehtësise dhe mjeteve dezinfektuse, shumohen me mungesë të oksigjenit, shfaqen pas dëmtimit të indeve. Sëmundjet e shkaktuara nga Klostridiet janë Këmbëzeza, Edema Malinje, Sëmundja e Zezë, Hemoglobinuria Bacillare, Gangrena Gazoze, Clostridium Tetani, Dezinteria e Qengjave, Clostridium Botulinum. Futja në inde e shkaktarit bëhet nëpërmjet plageve ose ushqimit të kafshëve. Sëmundjet të kafshët shkaktojnë ngordhje masive akute, aborte dhe kalojnë te njerëzit që konsumojnë produktet e tyre dhe janë shumë të rrezikshme. Në rast se shfaqet sëmundja dhe terapia nuk ka sukses kafsha duhet të asgjësohet. Te Klostridiet enterotoksemike mortaliteti është deri 100%.
- c) Vaksinimi i qenve duhet të bëhet si masë parandaluse kundër sëmundjes së tërbimit, me çka parandalohet rrezikimi i shëndetit të popullatës nga kafshimi i qenve. Vaksinimi është i efektshëm për një vit për qenë, ku mbrohet shëndeti i qenve dhe shëndeti publik, edhe në rast se e kemi ndonjë kafshim nga ndonjë qen, nuk paraqet rrezik tek njerëzit për arsye se është i vaksinuar

Specifikat tjera të thirrjes publike

- **Thirrja publike për aplikim hapet më 13.10.2020 dhe mbyllet më 27.10.2020**
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen.
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje do të refuzohen.
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DBPZHR.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit,
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar të ordinancës veterinare
- Certifikata me numër fiskal,
- Kopja e Licencës
- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit,
- Kopja e kartelës së xhirollogaroisë
- Dëshmia se ka përvojë në realizimin e projekteve duke siguruar dëshmi të realizimit të projekteve të ngjashme në të kaluarën.

Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes

- Të ketë biznesin e regjistruar dhe të ushtrojë veprimtarinë së paku 5 vite,
- Të jetë i licencuar në fushën e veterinars

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarfë të mbyllur,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimi në katin e parë në objektin e Komunës.


Berati Duraku
Drejtör